



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



**Programi: Bachelor**

**Drejtimi: Gazetari**

**Lënda: Gramatikë për gazetarë 2**

*Pedagogu:* Prof. Asoc. Dr. Linda Mëniku  
*Ngarkesa:* 2 ETCS (15 javë: 1.5 leksione në javë)  
*Lloji i lëndës:* me detyrim  
*Viti/semestri:* II/I

**Përshkrimi:**

Studentët e gazetarisë duhet të zotërojnë më së miri rregullat e gramatikës dhe të pikësimit të gjuhës shqipes, në funksion të përmirësimit të aftësive të tyre në të shkruar dhe në redaktim. Temat janë ndërtuar me një ndërthurje të anës teorike dhe asaj praktike, duke synuar kryesisht aftësimin praktik të studentëve. Tekstet e përzgjedhura, si dhe shembujt e ndryshëm të marrë nga media, synojnë në një rifreskim dhe konsolidim të njohurive të studentëve të gazetarisë për përdorimin sa më të saktë të strukturës së fjalive dhe në përgjithësi të ndërtimit të teksteve në gazetari.

Lënda “Gramatikë për gazetarët II” është ndërtuar mbi bazën e leksioneve ku temat konkrete trajtohen përmes dhënies së shembujve të shumtë. Leksionet janë konceptuar si leksione ndërvepruese ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive, duke sjellë shembuj të ndryshëm të marrë nga media shqiptare. Studentëve do t’u kërkohet çdo javë mbledhja paraprake e materialit nga media, në lidhje me temën përkatëse javore. Duke u nisur nga materialet e mbledhura, të bazuara kryesisht në gjetjen e shmangieve nga rregullat e pikësimit dhe ndërtimet e pasakta, në leksion do të sqarohen rregullat përkatëse, duke synuar në të kuptuarit logjik të materialit teorik dhe të atij praktik.

**2. Temat e leksioneve**

Java	Tema	Literatura
1	Përdorimi i emrit në trajtë të shquar dhe të pashquar. Përdorimi i foljeve gjysmëndihmëse <i>mund</i> dhe <i>duhet</i> .	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.157-164.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.88-94.</i>
2	Përshtatja e foljeve-kallëzues në kohë, me kryefjalën. Ndërtimi pësor.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.164-170.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.198-201.</i>
3	Emri dhe përemri në funksionin e kundrinorit. Përdorimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë. Mbiemri në funksionin e përcaktorit.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.170-179.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.221-242.</i>
4	Përdorimi i parafjalëve, i pjesëzave para gjymtyrëve homogjene dhe përdorimi i disa lidhëzave dhe i fjalëve lidhëse.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.179-190.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.295-326.</i>
5		<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.34-41.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.295-326.</i>

6	Përdorimi i presjes te gjymtyrët homogjene pa lidhëza, te gjymtyrët homogjene me lidhëza.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.13-22.</i>
7	Përdorimi i pikës.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.23-29.</i>
8	Përdorimi i pikëpyetjes.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.29-34.</i>
9	Përdorimi i pikëçuditëses.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.41-49.</i>
10	Përdorimi i presjes te gjymtyrët e veçuara.	<i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.229-353.</i> <i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.49-57.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.463-476.</i>
11	Përdorimi i presjes te periudhat me fjali të bashkërenditura, te fjalitë e nënrenditura para dhe pas fjalisë drejtuese.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.57-65.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.525-536.</i>
12	Përdorimi i presjes te fjalitë përcaktore dalluese dhe përshkruese, te fjalitë vendore, kohore, rrjedhimore, shkakore.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.65-73.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe II, fq.73-603.</i>
13	Përdorimi i presjes në fjalitë rrjedhimore, krahasore, kushtore, lejore, dhe në fjalitë e lidhura pa lidhëza.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.74-87.</i>
14		
15	Përdorimi i pikëpresjes. Përdorimi i dy pikave. Përdorimi i shumëpikëshit.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.88-104.</i>
	Përdorimi i thonjzave. Përdorimi i kllapave. Përdorimi i vizës.	<i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe, fq.105-112.</i>
	Pikësimi në shënimet në fundfaqe. Takimi i dy ose i më shumë shenjave të pikësimit dhe radha e tyre. Shenjat tipografike.	

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- <i>Detyra e kursit</i> : rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5.	10% e notës
- <i>Kontrolli përfundimtar</i> : provim me shkrim	80% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

Kostallari, A., Lafe. E., Totoni, M. “Gjuha letrare shqipe për të gjithë”, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1976.  
Akademia e Shkencave e Shqipërisë. “Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2002.

**Literatura plotësuese:**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. “Gramatika e gjuhës shqipe II”, Tiranë, 2002.